

Karta Identitetit Elektronike (K.I.E)

Çfarë është

Sipas nenit 10 pika 3 e Dekretit Legjislativ nr. 87/ 2015 e ndryshuar nga Ligji 125/2015, **Karta e re e Identitetit** është vetëm **Elektronike**, dhe ka si funksion jo vetëm të identifikojë qytetarët por për shtetasit italianë mund të përdoret dhe si mjet identifikimi për të udhëtuar në vendet e Bashkimit Evropian, apo edhe në vende të tjera ku Italia ka bërë marrëveshje dypalëshe.

Nga data 3 Korrik edhe Komuna e Campi Bisenzio-s lëshon vetën këtë lloj Karte Identiteti të re. Sipas këtyre normave ligjore, Karta e identitetit **nuk mund të lëshohet më në karton**.

Si mund të aplikohet

Aplikimi mund të paraqitet që gjashtë muaj para skadencës të kartës së identitetit të vjetër sipas dy mënyrave të më poshtme:

1. Duke u prenotuar nëpërmjet portalit të Ministrisë së Brendshme tek **agjenda online** nga faqa e internetit- "Agenda Ministeriale C.I.E." - <https://agendacie.interno.gov.it/logInCittadino.do> Ministria ka vendosur këtë faqe interneti me qëllim që të ulët koha e pritjes në sportel në zyrat e Komunës.
2. Duke u paraqitur në **Komunë** pranë sporteleve të Gjendjes Civile (tek Palazzo Comunale- Piazza Dante n. 36)

Kjo Komunë ka vendosur që të përdorë të dyja mënyrat.

Më saktë:

1. Sipas **axhendës online - të martë paradite- të enjte paradite dhe mbasdite- të premte paradite**. Zyra do të respektojë orarin e prenotimit online dhe qytetari nuk kanë nevojë të mari numrin tek hyrja, është mjaftueshëm të prezantohet në orarin e fiksuar dhe të tregojë letrën e prenotimit.
2. Direkt **në Komunë - të hënë paradite- të martë mbasdite- të mërkurë paradite**. Zyra pranon kërkesat **pa prenotim online**. Në këtë rast është e nevojshme që qytetari të marrë numrin tek hyrja dhe të presë rradhën.

Për të miturit, të pamundurit, invalidët apo kush është i ndihmuar nga një person i vendosur nga gjykata, aplikimin mund ta bëj ai/ajo që i ka në ngarkim.


Çfarë nevojitet për aplikim

Operatorit të zyrës i nevojitet 1 **fotografi** për dokument e bërë së afërmi dhe një dokument identifikimi tjetër (si: pashaportë, patentë automjeti, licencë anijeje, licencë për mbajtje armësh, librezë pensioni, licencë për të drejtuar impiantë termikë, kartë identifikimi e lëshur nga një administratë shtetërore me kusht që të ketë një fotografi dhe pullë ose një nënshkrim tjetër të barazvlerfshëm).

Fotografia në fund do t'i rikthehet sërish qytetarit.

Karta e identitetit për të miturin

Karta e identitetit për të miturin nuk mund të lëshohet në asnjë rast pa praninë e tij/saj.

- Aplikimi duhet të bëhet nga prindi;
 - Lëshimi i kartës së identitetit bëhet vetëm me miratimin e të dy prindërve;
 - Nëse njëri nga prindërit nuk mund të jetë prezent në momentin e lëshimit të dokumentit mund të plotësojë formularin e më poshtëm për miratim.
-  Modulo di assenso

Si lëshohet K.I.E

Lëshimi i Kartës së Identitetit Elektronike bëhet eskuzivisht nga Ministria e Brendshme.

Pranë sportelit të Komunës bëhet vetëm aplikimi (si marrja e firmës dixhitale, skanerizimi i fotografisë, marrja e deklaratës në lidhje me dhurimin e organeve, etj...).

Marrja e Kartës së Identitetit Elektronike bëhet me postë rakomande, brenda 6 ditë pune, në adresën e dhënë kur është bërë aplikimi.

Karta e Identitetit Elektronike është e pajisur me një mikroçip ku janë të ruajtura të dhënat identifikuese të titullarit, si dhe disa elementë biometrike fillestare (siç është fotografia) dhe më të avancuara (gjurmët e gishtave).

Kujtomë gjithashtu që, Karta e Identitetit Elektronike mund të përdoret për t'u futur në rrjete që ofrojnë shërbime publike. Zyra e Gjendje civile lëshon pjesën e parë të një kodi Pin dhe Puk. Ndërsa pjesa tjetër vjen sëbashku me Kartën e Identitetit Elektronike në shtëpi.

Vlefshmëria e K.I.E

Përsa i përket vlefshmërisë ajo nuk ka ndryshuar në krahasim me atë të mëparshmen në karton.

- 10 vjet për ata që janë në moshë madhore;
- 5 vjet për të miturit që janë nga mosha 3 deri më 18 vjeç;
- 3 vjet për të miturit nën tre vjeç.

K.I.E dhe raste të veçanta

Siç u lartëpërmend, Karta e Identitetit në karton nuk mund të lëshohet më.

Megjithatë ligji parashikon disa raste të veçanta:

1. Për motive shëndetësore: është rasti kur aplikuesi është në krevat dhe për arsye të veçanta nuk mund të paraqitet personalisht pranë zyrave të komunës.
2. Për motive udhëtimi- në afërsi të nisjes- në pamundësi të pritjes për kohën teknike të lëshimit të kartës: aplikuesi duhet të paraqisë dokumentacionin e nevojshëm që të vërtetohet urgjenca e nisjes për udhëtim jashtë vendit (kopje të biletës së udhëtimit, ose të

prenotimit .apo dokumente të tjera të vlefshme) ose në rast **humbjeje apo vjedhjeje** të kartës së identitetit të tregojë letrën e dononcimit të bërë në Polici.

3. Marja pjesë në tendera apo konkurse publike me afat shumë të shkurtër mbylljeje: aplikuesi duhet të paraqesë dokumentacionin e duhur për të vërtetuar këtë urgjencë.

Vetëm në këto raste mund të lëshohet Karta e Identitetit në Karton. Bashkangjitur me kartën e identitetit të vjetër janë të nevojshme 3 fotografi për dokument të bëra së afërmi.

Si duhet të jenë fotot

Fotot që nevojiten për lëshimin e kartës së identitetit duhet të jenë të bëra sipas normave të parashikuara nga Ministria e Brendshme. Shiko faqen e internetit për më shumë informacione.

[link](#)

Mundësia për t'u shprehur për dhurimin e organeve

Karta e re e Identitetit parashikon mundësinë që çdo qytetar në moshë madhore mund të vendosë për dhurimin apo jo të organeve/të indeve në rast vdekjeje.

Përsa i përket kësaj zgjedhjeje, qytetari përveç momentit të aplikimit për kartë identiteti elektronike mund të vendosë edhe në një moment të dytë.

Për çdo paqartësi apo për më shumë informacione mbi këtë zgjedhje qytetari këshillohet që të informohet më parë, pranë zyrave të Ambulancave qendrore (A.S.L) apo tek mjeku i familjes.

Zyrat e Gjendjes civile nuk mund të japin shpjegime mjeksore mbi këtë zgjedhje.

Theksojmë që kjo zgjedhje mund të ndryshohet në çdo moment, është i vlefshëm vetëm zgjedhja e fundit e bërë në kohë. Për këtë rast ju këshillohet të shkoni pranë Ambulancës qendrore (Azienda Sanitaria).

Shtetasit që nuk bëjnë pjesë në Bashkimin Evropian

Shtetasit që nuk bëjnë pjesë në BE duhet të paraqesin gjithashtu dokumentacionin në vijim: leje qëndrimi të vlefshëm ose kopje të lejes së qëndrimit të skaduar bashkangjitur me mandat pagesën e rinovimit të bërë 60 ditë para skadencës (permesso di soggiorno con ricevuta di rinnovo)

Si të bllokohet K.I.E në rast humbjeje apo vjedhjeje

Në rast se Karta e Identitetit Elektronike që është akoma e vlefshme humbet apo vidhet duhet bërë menjëherë denoncimi në Polici. Denoncimi duhet bërë edhe në qoftëse është i prishur si modeli në Karton apo ajo Elektronike dhe nuk mund të lexohen të dhënat identifikuese.

Për të kërkuar bllokimin e Kartës së Identitetit duhet të kontaktoni numrin **800263388** dhe të jepni këto të dhëna:

- emër mbiemër

- kodin fiskal
- numrin e Kartës Identitetit Elektronike nëse e keni të disponueshëm
- të dhënat e denoncimit që keni bërë në Polici

Sa kushton dhe mënyra e pagesës

Si aplikim për herë të parë apo ribërje të K.I.E është parashikuar nga Ministria një shumë prej 16,79 euro, ndërsa nga Komuna janë vendosur dy shuma, njëra fikse prej 5,16 euro dhe tjetra 0,26 euro për të drejtat e sekretarisë; gjithësej për t'u paguar janë 22,21 euro. Kjo shumë mund të paguhet vetëm në lekë kesh, direkt në sportel kur aplikohet në Komunë.

Normat ligjore

- Dekreti Legjislativ 78/2015 që i referohet “ Udhëzime urgjente për organet vendore” i ndërruar nga Ligji 6 gusht 2015, nr.125;
- Dekreti Ministri së Brendshme më datë 23 dhjetor-it 2015, i publikuar në Gazetën Zyrtare më 30.12.2015;
- Neni 5 i Dekretit Legjislativ më 7 Mars 2005, nr 82, me titull ‘ Kodi dixhital i administratës’
- Neni 3 T.U.L.P.S.;
- Neni 291 pika 3, Dekreti Regio më datë 06.05.1940, nr. 635; Dekreti i Presidentit të Republikës më datë 06/08/1974 nr. 649;
- Neni 31 i Ligjit 133/2008; Qarkore nr. 10/2016 - Ministria e Brendshme - K.I.E
- Qarkore nr. 11/2016- Ministria e Brendshme- Udhëzime shtesë për lëshimin e K.I.E